

VENDIM
Nr. 554, datë 29.7.2022

**PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARISË SË DHURIMIT VULLNETAR TË
GJAKUT NGA PUNONJËSIT/NËPUNËSIT E ADMINISTRATËS SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 9739, datë 21.5.2007, “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet e administratës shtetërore organizojnë çdo muaj, sipas një grafiku të përcaktuar prej tyre, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, veprimtari të dhurimit vullnetar të gjakut, pa pagesë, nga punonjësit /nëpunësit e administratës shtetërore.

2. Institucionet e administratës shtetërore njoftojnë punonjësit/nëpunësit e tyre për ditët e planifikuara të dhurimit vullnetar të gjakut.

3. Punonjësit/nëpunësit e administratës shtetërore, të cilët dhurojnë vullnetarisht dhe pa pagesë gjak, kanë të drejtë:

a) të largohen ditën e dhurimit kundrejt detyrimit të institucionit për të paguar rregullisht ditën e punës;

b) të marrin pushim ditën e nesërme të dhurimit kundrejt detyrimit të institucionit për të paguar rregullisht ditën e punës.

4. Institucionet të marrin masa për të garantuar mirëfunksionimin e veprimtarisë së tyre në ditët që punonjësit/nëpunësit largohen nga puna për arsyen e lartpërmendur.

5. Punonjësit/nëpunësit e administratës shtetërore, të cilët dhurojnë vullnetarisht dhe pa pagesë gjak, minimalisht tri herë në vit, mund të akomodohen, kundrejt tarifave preferenciale të përcaktuara, 7 (shtatë) ditë në Shtëpinë e Pushimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme, sipas një grafiku të përcaktuar nga institucioni përkatës me dy ministritë e përmendura në këtë pikë.

6. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama